

URDHËR
Nr.449, datë 21.6.2011

**PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË KËRKESAVE
DHE TË DOKUMENTACIONIT SHOQËRUES TË SHOQËRIVE QË DO TË PAJISEN ME LEJE
PËR NDËRTIMIN E PËRDORIMIN E INFRASTRUKTURËS SË SISTEMEVE TË GAZIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.713, datë 25.8.2010 “Për përcaktimin e rregullave për kushtet e procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror”, si dhe të vendimit nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”,

URDHËROJ:

1. Komisioni i vlerësimit të kërkesave dhe të dokumentacionit shoqëruar të paraqitura nga shoqëritë që kërkojnë të pajisjen me leje për ndërtimin e përdorimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit, konstituohet 15 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij urdhri, me përbërje dhe drejtim sipas pikave 10 dhe 11 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.713, datë 25.8.2010 dhe fillon funksionimin mbi bazën e njoftimit nga kryetari i komisionit.

2. Komisioni mbledhet për shqyrtimin e kërkesave brenda një periudhe prej 15 ditë pune nga data e depozitimit të kërkesës nga ana e shoqërive të interesuara. Data e mbledhjes caktohet nga kryetari i komisionit dhe njoftimi i anëtarëve bëhet jo më vonë se 5 ditë para zhvillimit të mbledhjes.

3. Në mbledhjen e radhës së komisionit, shqyrtohen edhe kërkesa të tjera të ardhura deri 10 ditë para datës së mbledhjes së komisionit.

4. Njësia përgjegjëse për aktivitetin e sektorit hidrokarbur, në përbërje të strukturës së Ministrisë, bën trajtimin dhe përpunimin e dokumentacionit të paraqitur nga shoqëritë që kërkojnë të pajisjen me leje për ndërtimin e përdorim e infrastrukturës së sistemeve të gazit, referuar përcaktimeve të pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.713, datë 25.8.2010, njofton komisionin, si dhe përgatit informacion për çdo kërkesë të depozituar.

5. Mbledhja e komisionit konsiderohet e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se $\frac{3}{4}$ e anëtarëve të tij.

6. Anëtarët e komisionit nuk mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjerë. Në rastet kur për arsye të pashmangshme ndonjë nga anëtarët e komisionit nuk mund ta kryejë këtë funksion, komisioni plotësohet me anëtarin e caktuar nga ministri përkatës.

7. Në mbledhje mbahet procesverbali në të cilin pasqyrohet pjesëmarrja në komision, çështjet që diskutohen, diskutimet e anëtarëve të komisionit, si dhe vendimi që merret.

8. Komisioni shqyrton dokumentacionin e paraqitur sipas pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.713, datë 25.8.2010, duke pasur në konsideratë që:

a) në vlerësim për kredibilitetin financiar të subjektit, ai do të vlerësojë burimet e financimit, përfshirë edhe gjendjen në llogarinë bankare në momentin kur paraqitet kërkesa.

b) në vlerësimin për dokumentacionin e përvojës në fushën e ndërtimit dhe përdorimit të instalimeve bregdetare, ai do të vlerësojë dokumentacionin ku pasqyrohet eksperiencia dhe aktiviteti i deritanishëm në këtë fushë i shoqërisë kërkuese apo i bashkimit të shoqërive, ose i shoqërisë që do të zbatojë projektin, qoftë kjo *joint-venture* me shoqërinë investitore apo kontraktor i deklaruar nga shoqëria investitore.

9. Vendimi i komisionit është i vlefshëm në qoftë se për këtë vendim votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të komisionit. Anëtarët e komisionit të cilët votojnë kundër shprehin qëndrimin e tyre në procesverbalin e mbledhjes.

10. Vendimi i komisionit, i cili merret brenda afatit prej 30 ditësh të përcaktuar në pikën 14.a të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.713, datë 25.8.2010, hartohet konform qëndrimit të shprehur dhe votimit të bërë dhe firmoset nga kryetari dhe të gjithë anëtarët e komisionit. Vendimi i paraqitet Ministrit për dhënien e subjektit kërkuar të “Autorizimit të përkohshëm” për vazhdimin e procedurave për plotësimin e dokumentacionit teknik dhe ekonomik për projektin, si dhe për realizimin e praktikave përkatëse deri në marrjen e lejes.

Kryetari i komisionit njofton subjektin kërkuar brenda 5 ditëve nga data e miratimit të “autorizimit të përkohshëm”.

11. Subjekti i pajisur me “autorizim të përkohshëm” paraqet në Ministri, brenda afatit të

përcaktuar në këtë “autorizim të përkohshëm”, dokumentacionin e plotë të përcaktuar në pikën 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.713, datë 25.8.2010, për marrjen e lejes për ndërtimin e përdorimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit.

12. Komisioni me marrjen e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i interesuar, mbledhet dhe shqyrton atë në përputhje me detyrat e përcaktuara në pikën 17 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.713, datë 25.8.2010, duke marrë vendimet përkatëse.

13. Anëtarët e komisionit shpërblehen për çdo mbledhje të shqyrtimit të kërkesave në vlerën 10.000 lekë, kurse kryetari 15.000 lekë. Ky shpërblim do të sigurohet nga të ardhurat e Ministrisë, në mbështetje të vendimit nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.

14. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet njësia përgjegjëse për aktivitetin e sektorit hidrokarbur, si dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit.

Ky urdhër hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço